

UDHËZIM
Nr. 8, datë 28.6.2012

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 24, DATË 30.7.2010 “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, MASËS DHE PROCEDURAVE PËR PËRFITUESIT NGA FONDI I EKSELENCËS PËR STUDENTËT E SHKENCËTARËT E RINJ, TË SHKËLQYER

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor të Republikës së Shqipërisë”, të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012” dhe të vendimit nr. 554, datë 7.7.2010 të Këshillit të Ministrave “Për fondin e ekselencës, për mbështetje financiare të studentëve e shkencëtarëve të rinj, të shkëlqyer”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

I. Në kreun II të udhëzimit nr. 24, datë 30.7.2010 “Për përcaktimin e kriterëve, masës dhe procedurave për përfituesit nga fondi i ekselencës për studentët e shkencëtarët e rinj, të shkëlqyer”, bëhen këto ndryshime:

1. Germa “b” e pikës 1, të ndryshohet si më poshtë:

“b) Kanë arritur notë mesatare mbi 9, për shkencat natyrore, inxhinierike e të jetës dhe mbi 9.5, për shkencat ekonomike e shoqërore ose, përkatësisht, mbi 8 (B, sipas sistemit anglosakson) për shkencat natyrore, inxhinierike e të jetës, dhe mbi 8.5 (B+, sipas sistemit anglosakson), për shkencat ekonomike e shoqërore, për studimet e kryera jashtë shtetit në secilin cikël studimi.”.

2. Germa “a” e pikës 3.1, të ndryshohet si më poshtë:

“a) STP-ja verifikon plotësimin e dosjes me dokumentet e kërkuara në shtojcën nr. 1 të udhëzimit nr. 24, datë 30.7.2010. Kandidatët që paraqesin mangësi në dokumentacionin e aplikimit, përjashtohen nga përzgjedhja në fazat e mëtejshme.”.

3. Germa “a” e pikës 3.2, të ndryshohet si më poshtë:

“a) KP-të bëjnë një vlerësim për plotësimin e kriterëve dhe klasifikimin e kandidatëve përmes një sistemi pikëzimi, për fazën e intervistës.”.

4. Gerrat “a” dhe “b” të pikës 3.4, të ndryshohen si më poshtë:

“a) KP-të në bashkëpunim me STP-në, mbi bazën e rezultateve të përzgjedhjes së parë, si dhe të atyre të intervistës, bëjnë klasifikimin përfundimtar të kandidatëve, të nënshkruar nga anëtarët e KP-ve.

b) Kjo listë i dërgohet Ministrit të Arsimit dhe Shkencës për miratimin e kandidatëve fitues.”.

II. Në kreun III të udhëzimit nr. 24, datë 30.7.2010 “Për përcaktimin e kriterëve, masës dhe procedurave për përfituesit nga fondi i ekselencës për studentët e shkencëtarët e rinj, të shkëlqyer”, bëhen këto ndryshime:

1. Germa “a” e pikës 4.1 të ndryshohet si më poshtë:

“a) STP-ja verifikon plotësimin e dosjes me dokumentet e kërkuara në shtojcën nr. 2 të udhëzimit nr. 24, datë 30.7.2010. Kandidatët që paraqesin mangësi në dokumentacionin e aplikimit, përjashtohen nga përzgjedhja në fazat e mëtejshme.”.

2. Germa “a” e pikës 4.2, të ndryshohet si më poshtë:

“a) KP-të, bëjnë një vlerësim dhe klasifikim të kandidatëve përmes një sistemi pikëzimi për fazën e intervistës.”.

3. Gerrat “a” dhe “b” të pikës 4.4, të ndryshohen si më poshtë:

“a) KP-të në bashkëpunim me STP, mbi bazën e rezultateve të përzgjedhjes së parë, si dhe të atyre të intervistës bëjnë klasifikimin përfundimtar të kandidatëve, të nënshkruar nga anëtarët e KP-së.

b) kjo listë i dërgohet Ministrit të Arsimit dhe Shkencës për miratimin e kandidatëve fitues.”.

III. Në kreun IV të udhëzimit nr. 24, datë 30.7.2010 “Për përcaktimin e kriterëve, masës dhe procedurave për përfituesin nga fondi i ekselencës për studentët e shkencëtarët e rinj të shkëlqyer”, bëhen këto ndryshime:

1. Germa “a” e pikës 2.1, të ndryshohet si më poshtë:

“a) STP-ja verifikon plotësimin e dosjes me dokumentet e kërkuara në shtojcën nr. 3 të udhëzimit nr. 24, datë 30.7.2010. Kandidatët që paraqesin mangësi në dokumentacionin e aplikimit, përjashtohen nga përzgjedhja në fazat e mëtejshme.”.

2. Germat “a” dhe “b” të pikës 2.2, të ndryshohen si më poshtë:

“a) KP-të, mbi bazën e rezultateve të përzgjedhjes së parë, si dhe të atyre të intervistës bëjnë klasifikimin përfundimtar të kandidatëve.

b) Kjo listë i dërgohet Ministrit të Arsimit dhe Shkencës për miratimin e kandidatëve fitues.”.

IV. Në kreun VI të udhëzimit nr. 24, datë 30.7.2010 “Për përcaktimin e kritereve, masës dhe procedurave për përfituesit nga fondi i ekselencës për studentët e shkencëtarët e rinj, të shkëlqyer”, bëhen këto ndryshime.

1. Pika 1.1, të ndryshohet si më poshtë:

“1.1 Studentët që aplikojnë për ciklin e parë të studimeve, të kenë përfunduar arsimin parauniversitar me mesatare mbi 9 të të gjitha viteve të shkollës së mesme ose ekuivalente për ata që kanë përfunduar arsimin parauniversitar jashtë vendit me vlerësimin (A- deri A, sipas sistemit anglosakson).”.

2. Pika 1.2 të ndryshohet si më poshtë:

“1.2 Studentët që aplikojnë për ciklin e dytë të studimeve, të kenë përfunduar studimet e ciklit të parë, me notë mesatare mbi 9, për shkencat natyrore, inxhinierike e të jetës dhe mbi 9.5, për shkencat ekonomike e shoqërore ose përkatësisht, mbi 8 (B) për shkencat natyrore, inxhinierike e të jetës dhe mbi 8.5 (B+), për shkencat ekonomike e shoqërore, për studimet e kryera jashtë shtetit nëse.”.

3. Germa “a” e pikës 3.1, të ndryshohet si më poshtë:

“a) STP-ja verifikon plotësimin e dosjes me dokumentet e kërkuara në shtojcën nr. 5 të udhëzimit nr. 24, datë 30.7.2010. Kandidatët që paraqesin mangësi në dokumentacionin e aplikimit, përjashtohen nga përzgjedhja në fazat e mëtejshme.”.

V. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, komisionet përzgjedhëse dhe Sekretariati Teknik i Programit.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj